


Nr. Prot. 1



SHKOLLA PRIVATE E ARSIMIT TË LARTË "PAVARËSIA", VLORË

Tel: +355 33 4 11 555
Tel: +355 33 4 11 666
Fax: +355 33 4 11 777



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJBSC
Viti Akademik 2016-2017

Vlorë, më 27 /10/2016

Lënda: Relacion mbi nisjen e vitit akademik 2016-2017

Drejtuar: Rektorit Z.Prof.Dr.Luan Gjonçaj ,Zv.Rektorit Z.Siri Hoxha PhD

Për Dijeni : Administratorit Z.Ardian Zykaj

Nga: Kryetare e NJBSC Znj.Fabiola Deliaj

Më datë 20/10/2016 nisi zyrtarisht viti i ri akademik 2015-2016 në SHPAL 'Pavarësia' Vlorë, për ciklin e parë dhe të dytë (viti i dytë) të studimeve, me Urdhër Nr.455, datë 06.09.2016 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Oraret e të gjitha degëve janë afishur edhe në faqen zyrtare të institucionit tonë, në mënyrë të tillë që studentët të kenë akses të plotë mbi to.

Orët e leksioneve dhe seminareve janë zhvilluar normalisht duke pasur një pjesëmarrje të kënaqshme. Secila degë zhvillon **jo më shumë se pesë orë në ditë.**

NJBSC dhe anëtarët saj po angazhohen maksimalisht që çdo gjë të funksionojë sipas rregullores së institucionit.

Të rregjistruar sipas të dhënave të marra nga sekretaria qendrore e SHPALPV, për vitin akademik 2016-2017 janë respektivisht sipas degëve:

- Bachelor në Drejtësi 15 studentë
- Bachelor në Ekonomi 8 studentë
- Bachelor në Inxhinieri Informatike 6 studentë
- Bachelor në Shkenca Politike 0 studentë
- DIND në Arkitekturë 2 studentë



Ndërkohë që për vitin e kaluar akademik 2015-2016 të regjistruar janë:

Bachelor në Drejtësi 45 studentë
Bachelor në Ekonomi 27 studentë
Bachelor në Inxhinieri Informatike 18 studentë
Bachelor në Shkenca Politike 5 studentë
DIND në Arkitekturë 5 studentë

Për tu diplomuar në këtë vit akademik janë, pra studentë të vitit të tretë :

Bachelor në Drejtësi 33 studentë
Bachelor në Ekonomi 8 studentë
Bachelor në Inxhinieri Informatike 8 studentë
Bachelor në Shkenca Politike 0 studentë
DIND në Arkitekturë 3 studentë

Aktualisht pranë SHPALPV në ciklin e parë të studimeve janë **183 studentë.**

Në ciklin e dytë të studimeve procesi i regjistrimeve vijon ende. Aktualisht në vitin e dytë, pra në proces diplomimi sipas të dhënave të sekretarisë qendrore :

Master Shkencor Financë Publike dhe Administrim Publik 21 studentë
Master Profesional Financë dhe Kontabilitet i Firmave 6 studentë
Master Shkencor E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare Publike 9s studentë
Master Shkencor Diplomaci dhe Politikë Ndërkombëtare 7 studentë
Master Shkencor Inxhinieri Informatike 8 studentë
Master Shkencor Informatikë Ekonomike 1 studentë

Ndërkohë që për këtë vit të ri akademik , Bordi Drejtues , Rektorati dhe Komisionet e posaçme janë angazhuar maksimalisht lidhur me **rekrutime të reja konform ligjit të ri të arsimit të lartë.**